

**VENDIM**  
**Nr.206, datë 29.1.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.319, DATË 12.4.2017, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË PROJEKTIMIT TË**  
**SHKOLLAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në pikën 4.2.3 “Salla për edukim fizik”, të tekstit “Standardet e projektimit të shkollave”, bashkëlidhur vendimit nr.319, datë 12.4.2017, të Këshillit të Ministrave, nënndarja “Shkollat e mesme” ndryshohet, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen institucionet shtetërore dhe subjektet private të përfshira në procesin e projektimit, të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe të inspektimit të shkollave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

“Shkollat e mesme

Në shkollat e mesme, njëloj si në shkollat nëntëvjeçare, duhet patjetër të ketë një mjedis të veçantë të mbyllur (palestër) për edukimin fizik si dhe mjediset në oborrin e jashtëm të saj.

Mjedisi i veçantë i mbyllur (palestër) për edukimin fizik, si dhe mjediset e hapura në shkollat e mesme mund të jenë njëfunksionale ose shumëfunksionale, të tilla që në to të luhet basketboll, volejboll, hendboll dhe sporte të tjera.

- Përmasat për palestrën shumëfunksionale (pista e lojës) duhet të jenë 26 m x 44 m;
- Përmasat për palestrën njëfunksionale (pista e lojës) duhet të jenë 18 m x 26 m.

Përveç kësaj, salla e edukimit fizik duhet të ketë mjediset e veta ndihmëse:

- Dy gardëroba me madhësi 20 m<sup>2</sup> secili;
- Dy banja-dushe 20 m<sup>2</sup>;
- Një depo për veglat 20-30 m<sup>2</sup>;
- Mjedis për mësues me banjë-dush dhe gardërobë 16 m<sup>2</sup>.

Terrenet e jashtme sportive caktohen sipas kërkesave të programit mësimor, ku duhen parashikuar:

- Fusha shumëfunksionale (fushë e përbashkët për basketboll, volejboll etj.)
- Fusha njëfunksionale:
- Një fushë volejbolli;
- Një fushë basketbolli;
- Një kënd gjimnastikor;
- Një fushë tenisi.

Në shkollat e mesme me më shumë se 600 nxënës duhet patjetër të ketë një mjedis të veçantë të mbyllur (palestër shumëfunksionale) ose terren të jashtëm sportiv (fushë shumëfunksionale) për edukimin fizik.”

